

FJALA E DEPUTETES ERISA XHIXHO

E ENJTE 8 SHTATOR 2022

E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar pak kolegë deputetë që kemi ngelur,

Në fakt, është shumë e turpshme se si ky tempulli i demokracisë, që duhet të jepte mesazhin më të qartë të mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë të qytetarëve, jep mesazhin më të padrejtë ndaj qytetarëve, pra se si disa deputetë duhet të flasin para votimit, se si disa nuk duhet të flasin. Po, mirë, në qoftë se kryetarët e grupeve parlamentare paskan shkëlur edhe Rregulloren, edhe principin logjik pse është vënë ai nen në Rregullore, ka diskutime, ka debate dhe më pas votohet, përndryshe për çfarë flasim ne?! Për çfarë flas unë dhe të gjithë kolegët deputetë, pasi votohet? Deri dje e kemi bërë për shkak të pandemisë, e kemi kundërshtuar, dhe sot vazhdojmë ende ta bëjmë.

Pse?! Sepse disa kryetarë grupesh parlamentare qenkan mbi Rregulloren; qenkan mbi logjikën normale juridike të qytetarëve shqiptarë, duke dhënë mesazhin që këtu më i forti dhe më i pushtetshmi flet para votimit e disa të tjerë janë të diskriminuar! Më lejoni të kujtoj që unë sot, personalisht, përfaqësoj 30 mijë vota, por ky sistem i padrejtë elektoral një force, që ka marrë 95 107 mijë vota, i ka dhënë 4 mandate deputetësh; kam më shumë vota se Kryeministri apo se ndonjë tjetër si forcë politike. Atëherë, të vijë ai të flasë në fund, pas votimit, dhe jo ne, sepse nuk ka asgjë më shumë, përkundrazi sjell sot një akt normativ, i cili përfaqëson fytyrën më të mirë se si kjo forcë politike nuk është e majtë, nuk i do të varfrit dhe po i lë vetëm edhe në momentin më kritik të tyre. Kjo është e vërteta e sotme.

Për të ardhur tek akti normativ, sepse atij dua t'i kushtoj vëmendje në këtë hapësirë që kam me publikun dhe me qytetarët. Në fakt, është e habitshme se si shikon sot ministrat që diskutuan, Kryeministrin të ftohtë akull, të cilët kërkojnë mirëkuptim për këtë situatë në të cilën ndodhen, mirëkuptim qeverisë më të korruptuar në Europë Qeveria, e cila ka pasur lekë për PPPtë, për

koncesione, por jo sot për qytetarët nuk ka lekë, nuk ka mundësi që të ketë një paketë të vërtetë reale sociale që t'u vijë në ndihmë! Ndërkohë që qeveria pranon vetë që ka rritur të ardhurat, jo se ka sjellë ndonjë investitor të huaj, jo se ka hapur ndonjë front pune, por nga shqiptarët, të cilët paguajnë çdo ditë çmime marramendëse.

Ka mbushur arkën e shtetit me 400 milionë euro nga janari deri në korrik dhe çfarë i jep, i jep një paketë që vlerësohet në 60 milionë euro. Komplet qesharake! Ndërsa qytetarët varfërohen, kjo qeveri pasurohet dhe i mbledh lekët me të dyja duart, por i jep me pikatore për qytetarët. Kjo paketë nuk sjellë asgjë të re dhe është vazhdimi i asaj paketës së vjetër, që nxori FMN-ja dhe bënte thirrje të ndihmonit të varfri. Dhe kujt ia bën? Një force të majtë, pseudo të majtë që duhet të mbronte të varfrit, sidomos në këto kohë krizash. Sërish asnjë paketë sociale, por një paketë, e cila nxjerr hapur vetminë, në të cilën ndodhen qytetarët sot. Por ka lekë buxheti, 1,67 miliardë lekë për kompanitë e ndërtimit! Në vend që të mbështetet biznesi i vogël, të rimbursohen kostot e biznesit të vogël, jo, rimbursohen bizneset e mëdha, ndërtuesit që qeveria u jep kontrata publike.

Të dashur qytetarë, paratë janë, janë aty dhe janë tuajat, por qarkullojnë në një dorë të rrethit të qeverisë, ndërkohë që me mijëra shqiptarë këtë verë nuk patën mundësi të bëjnë as një javë pushime. Ata vazhdojnë të paguajnë inceneratorë fantazmë; nuk ndërpriten pagesat e inceneratorëve, absolutisht janë të paprekshme; plot 420 milionë euro do t'u kushtojnë shqiptarëve. Plot 80 mijë euro në ditë dalin nga xhepat e shqiptarëve për të përfunduar tek ato të Klodian Zotos e me shokë, që kush e di në çfarë resortesh luksoze po pushojnë. Ndërkohë, paketë për lehtësi real të efekteve të krizës nuk ka për shqiptarët. Ndërkohë, kemi kulmin e arrogancës, që është "Edeni" që kanë bërë në Kryeministri, që u kushton plot 4 miliardë e 300 milionë lekë shqiptarëve.

Një Eden i vogël në Kryeministri, një turp dhe një simbol i arrogancës në kulmin e një krize të rëndë ekonomike! Shqiptarët mezi mbijetojnë dhe këtu na ofrohen lekët, që shkojnë për mjedise luksi për Kryeministrinë. Qytetarëve u thonë fikni dritat, madje u jepen edhe këshilla grave t'i lajnë rrobat me 30 gradë. Po thojuni shqiptarëve sot që e energjia elektrike do të rritet dhe do të 4-fishohet për shtresën e mesme. Thojeni këtë të vërtetë, se në vendin ku 1 kilometër

rrugë kushton 20 milionë euro, në këtë vend do të rritet energjia, ndërkohë që Kosova bën një paketë të vërtetë dhe u jep 100 euro studentëve. Të hënën fillon viti i ri akademik, por studentët nuk përfshihen fare në këtë paketë.

Janë një kategori që kjo qeveri nuk e njeh, sepse edhe në buxhetin, në aktin normativ të kaluar, që preku të parin, arsimit ishte pikërisht me 15 milionë dollarë, sepse nuk i ka prioritet të rinjtë, sepse nuk e ka prioritet arsimin! U thotë: “Keni libra falas”, ndërkohë që duhet t’u thotë të vërtetën, se nuk janë libra të rinj, por të përdorur! Po qajnë fëmijët nëpër shtëpi, u thonë prindërve: “A ke lekë, se dua libra të rinj?”, se në një klasë ka fëmijë të diskriminuar. Kush ka lekë, blen libra të rinj dhe, kush nuk ka lekë, vazhdon me të përdorurit (janë me laps, por ndoshta ministrja nuk e ka parë). Por do t’i shohë shumë shpejt, sepse do t’ia bëjmë të ditur! Kjo është e vërteta!

Ndërkohë, fëmijët këtë dimër do të ftohen nëpër klasa, sepse nuk do të ketë ngrohje, siç nuk ka pasur, ndërkohë që sistemi ynë arsimor po vazhdon të degradohet dhe të dështojë. Pamjet e gomoneve me të cilat rinia ikën janë aq të dhimbshme, por qeveritarët tanë nuk kanë sy për t’i parë ato pamje dhe për të kuptuar se është dështimi i sistemit arsimor që ka sjellë efektin e largimit të të rinjve, sepse këtu, edhe kur një fëmijë edukohet 2 orë në ditë, merr të mësojë kiminë ose fizikën, nuk ka laborator ta zbatojë atë në praktikë. Bëjnë 2 orë teori, teori, teori, ama nuk i përgatisin për asgjë, as për mendimin kritik, as për të qenit qytetarë të aktivizuar, që të dinë të drejtat e tyre dhe të luftojnë.

Prandaj largohen dhe nuk kthehen më, fatkeqësisht! Në fund të fjalës sime, do të desha t’ju rikujtoja se kemi depozituar, si forcë politike, një projektligj për indeksimin e pagave dhe është një projektligj që i vjen në ndihmë çdo qytetari dhe çdo familjeje. Do të ishte në nderin e këtij parlamenti ta miratonte sa më parë dhe do të ishte një ndihmë reale për qytetarët që presin rritje pagash, që presin ndihmë konkrete, që nuk presin lëmoshën për pensionistët 6%. Frutat janë bërë luks për pensionistët. E dini? E dini se vaji ka shkuar 4 mijë lekë dhe qumështi 2 mijë lekë? Dhe thoni këtu që keni rritur pensionet dhe po ndihmoni shtresën më vulnerabël, në fakt, shtresën që ju ka mbështetur më shumë ndër vite, duke ju votuar. Por duhet të reflektojnë se kë kanë votuar.

Së fundi, unë mendoj se drejtësia do të vijë shumë shpejt dhe në fund të ditës ajo do të bëhet nga populli shqiptar që ju po e detyroni të largohet të ndahet për së gjalli nga fëmijët, nga prindërit dhe nga toka e tyre, dhe që po e varfëroni! Por shumë shpejt ajo drejtësi do të vijë. Faleminderit!